

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 3887 Rep.

Nr. 1723 Kol.



KONTRATE
SHITJE E KUOTAVE

Ne Tirane, sot ne daten 26.07.2018 (dymije e tetembehjete), perpara meje noterit publik Ermal Xh. HAMZAJ, Anetar i Dhomes se Notereve Tirane, me licence profesionale nr.511, ne zyren time noteriale me adrese Rr: "Ismail Qemali", Nd.4, H.1 Tirane, u paraqiten personalisht shtetasit:

Z.Edmond BLLAKO, atesia Arqile, i datelindjes 04.04.1960, lindur ne Permet dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesine e plote juridike per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit Nr. personal G00404141L; referuar me poshte si "Shitesi";

dhe

Z. Ergys AGASI, atesia Bardhyl, i datelindjes 22.03.1987, lindur ne Durres dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plotë për të vepruar, mbajtes i Pasaportes nr. Personal I70322075Q, referuar me poshte si "Bleresi".

MEQENESE ekzistojne faktet:

Z.Edmond BLLAKO eshte ortak i shoqerise "EA LOGISTICS" SHPK, shoqeri tregtare e se drejtes Shqiptare, e regjistruar ne regjistrin tregtar te QKB me date 02.08.2016, me NIPT/NUIS L62002012I, me zyre qendrore ne adresen Tirane, Njesia Bashkiake nr.5, Rruga "Ismail Qemali", Shkalla 2, Kati 2, Ap.2, dhe zoteron 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise.

Z.Edmond BLLAKO deklarone se deshiron t'i shes teresisht kuoten qe zoterone ne shoqerine ne "EA LOGISTICS" SHPK, qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise, ortakut ekzistues Z. Ergys AGASI, sipas kushteve te meposhtme.

Z. Ergys AGASI, deshiron t'i bleje Z.Edmond BLLAKO teresisht kuoten qe ai zoterone ne shoqerine ne "EA LOGISTICS" SHPK, qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise, sipas kushteve te meposhtme.

Palet e mesiperme me vullnet te lire dhe te plote, me kerkuan mua noterit hartimin e kesaj kontrate shitje kuotash, me permbajtjen si me poshte :

Neni 1
Qellimi i kontrates

- Qellimi i kesaj kontrate eshte transferimi i pronesise te kuotes ne kapitalin e shoqerise nga shitesi tek bleresi.
- Kjo kontrate sherben per percaktimin e kritereve, procedurave dhe menyres se tranferimit te pronesise dhe pageses perkatese lidhur me kete transferim.
- Ne percaktim te kushteve, palet konsiderojne te ligjshme permbajtjen e saj dhe marrin persiper te ekzekutojne veprimet e tyre brenda kushteve te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Objekti i kontrates

-Nepermjet kesaj kontrate, shitesi transferon ne favor te blesit teresisht kuoten qe ai zoteron ne shoqerine ne "EA LOGISTICS" SHPK, qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise, ne baze te cmimit te percaktuar ne nenin 3 me poshte.

-Gjithashtu, blesesi do te bleje nga shitesi teresisht kuoten qe ai zoteron ne shoqerine ne "EA LOGISTICS" SHPK, qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise, ne baze te cmimit te percaktuar ne nenin 3 me poshte.

Neni 3

Çmimi dhe menyra e pagimit

-Të dyja palët kanë rënë dakort midis tyre qe çmimi i shitjes te kuotes qe shitesi transferon ne favor te blesit do te jete **50.000 LEK** (pesedhjetemije lek).

-Po ashtu, te dyja palët deklarojnë se shuma e mësipërme i eshte shlyer teresisht pales shiteses nga ana e pales blesese perpara nenshkrimt te kesaj kontrate jashte zyres noteriale dhe se nuk kane asnje pretendim financiar kundrejt njeri tjetrit.

Neni 4

Pergjegjesite dhe garanci te paleve

Palet nepermjet kesaj kontrate per shitje kuotash garantojne si me poshte:

- a) Shitesi garanton se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotave qe po trasferohen me kete kontrate shitje;
- b) Shitesi garanton se kontributi monetar i derdhur prej tij per zoterimin e kuotave, objekt te kesaj kontrate shitje ben pjese ne pasurite vetjake ne referim te nenin 77 te Kodit te Familjes ne fuqi.
- c) Shitesi garanton se kuotat objekt shitje jane plotesisht te lira nga çdo barre, detyrim, te drejta reale apo cdo lloj kufizimi tjetër.
- d) Shitesi garanton se nen pergjegjesine e tij personale me nenshkrimin e kesaj kontrate pasi ai te kete perfituar te gjithe çmimin e shitjes sipas kesaj kontrate, ai do te heq dore nga te gjitha te drejtat qe i kane takuar ne cilesine e ortakut ne shoqeri, apo çdo te drejte tjetër pa kufizim ku perfshihen te drejta pune, etj.
- e) Palet detyrohen te mbajne konfidencial te gjithe dokumentacionin, te dhenat dhe çdo informacion te perfituar gjate marrdhenies se tyre ne shoqeri apo dhe referuar marredhenies konkrete te krijuar me kete kontrate.

NENI 5

Kalimi i pronesise

-Menjehere mbas nenshkrimt te paleve, kontrata do te depozitohet dhe regjistrohet nga bleresi prane regjistrin tregtar te QKB.

-Me nenshkrimin e kesaj kontrate, kapitali i shoqerise do te zoterohet 100% nga ortaku ekzistues i saj **Z. Ergys AGASI**.

NENI 6

Efektet e kontrates

-Kjo kontrate ka fuqine e ligjit per palet nga momenti i nenshkrimt te saj perpara noterit dhe mund te ndryshohet vetem me marreveshje me shkrim dypaleshe.

-Kontrata ka efekt per palet e treta ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

NENI 7

Ligji i aplikueshem dhe Gjykata kompetente

-Kontrata eshte hartuar ne perputhje me Legjislacionin tregtar ne fuqi.

-Bleresi dhe shitesi angazhohen te bejne cdo perpjekje per zgjidhjen e mosmarreveshjeve apo konfliktet te mundshme qe mund te krijohen midis tyre, lidhur me kete kontrate nepermjet negocimeve te drejteperdrejta.

-Nese palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve apo konflikteve midis tyre, ceshtja do ti nenshtrohet juridiksionit gjyqesor.

NENI 8

Dispozita perfundimtare

-Kjo kontrate eshte hartuar ne 4 (kater) kopje, ne gjuhen Shqip, me vlere te njejte ligjore nga nje per secilen pale, e cila ju lexua me ze te larte e te qarte paleve nga une noteri ne gjuhen Shqip.

-Palet deklaruan se e degjuan, e kuptuan dhe meqenese kontrata eshte hartuar ne perputhje me vullnetin e tyre dhe ligjin, e nenshkruan personalisht dhe pa verejtje perpara meje noterit.

-Pas nenshkrimit te paleve, une noteri e nenshkrova dhe e vertetova kontraten sipas kerkesave te ligjit Nr.7829, date 01.06.1994 "Per Noterine ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar).

Gjithashtu palët autorizojnë mua noterin për përdorimin e të dhënave personale të tyre të bëra të ditura sa më sipër dhe se të dhënat e përdorura nga unë noteri në këtë dokument do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin e redaktimit të këtij akti. Përpunimi i të dhënave në akt do të bëhet në respektim të plotë dhe zbatim rigoroz të dispozitave të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 – i ndryshuar "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

PALET KONTRAKTORE

SHITESI

Edmond BLLAKO

Edmond Bllako

BLERESI

Ergys AGASI

Ergys Agasi

NOTERI

Ermal Xh.HAMZAJ

ERMAL XH. HAMZAJ

Ermal Xh. Hamzaj



Ermal Xh. Hamzaj

Shoqeria "EA LOGISTICS" SHPK

NIPT: L62002012I

Adresa: Tirane, Njesia Bashkiake nr.5, Rruga "Ismail Qemali", Shkalla 2, Kati 2, Ap.2

VENDIM datë 26 / 07 / 2018

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE

Sot me date 26 / 07 / 2018, u mbledh Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te Shoqerise "EA LOGISTICS" SHPK ne prezence te ortakut te te gjithë ortakeve te saj, qe zoterojne 100% te kapitalit te shoqerise, per te diskutuar, shqyrtuar dhe vendosur ne lidhje me rendin e dites si me poshte:

- Transferimi nepermjet shitjes te 1 (nje) kuote qe ortaku Z.Edmond BLLAKO zoteron ne shoqerine "EA LOGISTICS" SHPK, qe perfaqeson 50% te kapitalit ne favor te ortakut ekzistues Z. Ergys AGASI, kundrejt çmimit 50.000 LEK (pesedhjetemije leke).
- Te tjera.

Pas nje diskutimi te hollesishem te pikave te mesiperme, te perfshira ne rendin e dites, asambleja e pergjithshme e ortakeve, ne menyre unanime:

VENDOSI

- Miratimin e transferimit nepermjet shitjes te 1 (nje) kuote qe ortaku Z.Edmond BLLAKO zoteron ne shoqerine "EA LOGISTICS" SHPK, qe perfaqeson 50% te kapitalit ne favor te ortakut ekzistues Z. Ergys AGASI, kundrejt çmimit 50.000 LEK (pesedhjetemije leke).

Ngarkohet administratori i shoqerise apo çdo person i autorizuar prej tij per depozitimin e ketij vendimi ne Regjistrin Tregtar te Qendres Kombetare te Biznesit si dhe kryerjen e çdo lloj veprimi pa kufizim per arritjen e qellimit te mesiperm.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

Përfaqësuar nga:

Edmond BLLAKO



Ergys AGASI